

UDHËZIM
Nr. 4099, datë 3.11.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 1159, DATË 17.3.2014, TË MINISTRIT
TË SHETËTIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE, “PËR
HARTIMIN E MARRËVESHJES SË NIVELIT TË SHËRBIMIT”**

Në zbatim të pikës 2 të vendimit nr. 710, datë 21.8.2013 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

UDHËZON:

Pika 5 e udhëzimit nr. 1159, datë 17.3.2014, të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.MNSH-ja për pajisjet hardware, aplikacionet, licencat ose kombinimet e tyre duhet të fillojë menjëherë nga momenti i marrjes në dorëzim nga porositësi të pajisjes hardware, të aplikacionit, licencës apo kombinimit të tyre. Garancia për pajisjet hardware është me kohëzgjatje minimale 1-vjeçare.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRII SHETËTIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
Milena Harito